

NJOFTIM PUNËSIMI

Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	<p>Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.</p> <p>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për <u>një vënd pune: Përgjegjës Grupi pranë Njesisë së Prodhimit Fushë-Kuqe në Drejtorinë e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit</u> nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor të mbajtur për punimet e mirëmbajtjes.</p>
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	<ul style="list-style-type: none">• Organizon, koordinon dhe drejton mirëmbajtjen e veprave të prodhimit të ujit, nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve.• Merr pjese në analizën e avarive të ndodhura në njësinë e prodhimit, jep mendime për mënyrën e zgjidhjes dhe eliminimit të tyre si edhe jep shpjegime në lidhje me avaritë.• Bashkëpunon me Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe mbështet grupet e tyre të punës që dërgohen për zgjidhjen e problemeve teknike në njësinë e prodhimit.• Kontrollon ecurinë e punimeve për mirëmbajtjen e veprave të prodhimit të ujit dhe eliminimin e defekteve në kohë dhe cilësi sipas standardeve të kërkuara, kushteve teknike të zbatimit, rregullave për ruajtjen e mjedisit dhe të sigurisë në punë.• Zbaton planin e remonteve për pajisjet elektromekanike të stacioneve të pompimit.

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrollon dhe ndjek me korrektësi zgjidhjen ekzakte të problemeve të karakterit elektrik dhe mekanik.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 02.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. 	